



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:244989  
Datë: 27.02.2024  
Numri i dokumentit: 05383114

KPPP.nr.1856/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, kundër debitorit NP “DC OFFICE”, me NRB: 70686457, me adresë rruga “Hyzyri Talla” pn, Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.347/16 të datës 23.08.2016, të Përmbartuesit Privat Arsim Bajraktari me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 14.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit NP “DC OFFICE”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.347/16 të datës 23.08.2016, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Arsim Bajraktari, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, me datë 23.08.2016, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.347/16, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, Aktvendimit të Doganës së Kosovës 08.1.2/903 të datës 13.05.2015, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të

këtij urdhri, në emër të kundërvajtjes doganore, t'ia paguaj kreditorit shumën në vlerë prej 800.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, me arsyetimin se Aktvendimi i Doganës së Kosovës që i referohet datave 10.08.2015 dhe 10.09.2015 është i pabazuar, për faktin se rivlerësimi nga Dogana është kryer me vonesë prej dy viteve 2016-2013 dhe ka gjetur në mënyrë të pabazuar si përgjegjës biznesin DC Office, ngase përcaktimi i kodeve doganore nuk është kompetencë e bizneseve por e Doganës. Tutje ka theksuar se Aktvendimin për gjobë e ka pranuar me datë 18.08.2023, 10 vite pas kalimit në doganë, dhe ky dokument nuk i është ofruar biznesit DC Office përmes Përbaruesit, duke shtuar se nuk pajtohet me këtë Aktvendim në bazë të të cilit debitori obligohet ta paguaj gjobën prej 800.00 Euro, me shpresën se Gykata Komerciale do ta liroj nga gjoba.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, i cili në paragrafin 1 nënparagrafin 2 është përcaktuar se dokumente përbaruese janë (...) *“vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*. Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”*, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se *“Vendimi i dhënë në*

*procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktvendimin e Doganës së Kosovës 08.1.2/903 të datës 13.05.2015, në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Aktvendimi 08.1.2/903 i datës 13.05.2015, i nxjerrë nga Dogana e Kosovës, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi 08.1.2/903 i datës 13.05.2015, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi 08.1.2/903 i datës 13.05.2015, i nxjerrë nga Dogana e Kosovës, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i formës së prerë me datën 10.08.2015 dhe i ekzekutueshëm me datë 10.09.2015, e cila vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se nuk pajtohet me Aktvendimin në bazë të të cilit debitori obligohet ta paguaj gjobën prej 800.00 Euro, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1856/23, me datë 14.02.2024

Gjyqtari  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.